


Tregtia e jashtme e mallrave

Tetor 2020

Tiranë, më 17 Nëntor 2020: Në Tetor 2020 eksportet e mallrave arritën vlerën 27 mld lekë, duke u ulur me 0,9 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u rritur me 6,0 %, në krahasim me Shtator 2020. Importet e mallrave arritën vlerën 59 mld lekë, duke u ulur me 0,01 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u rritur 13,1 %, në krahasim me Shtator 2020. Deficiti tregtar i këtij muaji është 33 mld lekë, duke u rritur me 0,8 %, krahasuar me Tetor 2019 dhe 19,7 %, në krahasim me Shtator 2020.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave, Tetor 2020 (%)




Në dhjetëmujorin e 2020 eksportet e mallrave arritën vlerën 221 mld lekë, duke u ulur me 12,2 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 488 mld lekë, duke u ulur me 9,7 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 267 mld lekë, duke u ulur me 7,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2019.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Rënia vjetore e eksporteve prej 0,9 %, këtë muaj është ndikuar nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -5,0 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -2,1 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me -0,4 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Ushqim, pije, duhan” me +2,7 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +2,0 pikë përqindje, “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +1,9 pikë përqindje.

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Tetor 2020 (p.p)




Eksportet, gjatë këtij dhjetëmujori janë ulur me -12,2 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Tekstile dhe këpucë” me -6,2 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,8 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,3 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Ushqim, pije, duhan” me +1,1 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Rënia vjetore e importeve prej 0,01%, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,3 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me -0,4 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me -0,1 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +2,4 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +0,6 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +0,6 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Tetor 2020 (p.p)



Si dhjetëmujor, importet janë ulur me 9,7 %, krahasuar me dhjetëmujorin e 2019. Grupet që kanë ndikuar neaktivisht në uljen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -4,0 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -2,2 pikë përqindje, “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -1,5 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve nuk ka ndikuar pozitivisht asnjë grup.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Tetor 2020, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Tetor 2019 janë: Kosova (9,7 %), Gjermania (63,0 %), dhe Greqia (22,4 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-0,6 %), Spanja (-62,5 %), dhe Kina (-11,1 %).

Gjatë këtij dhjetëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Gjermania (14,3 %), Maqedonia e Veriut (0,6 %), dhe Serbia (43,0 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-16,6 %), Kosova (-17,5 %) dhe Spanja (-24,1 %).

Në muajin Tetor 2020, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Tetor 2019 janë: Italia (9,0 %), Greqia (17,6 %) dhe Gjermania (24,0 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Turqia (-16,2 %), Serbia (-3,2 %) dhe Zvicra (-35,1 %).

Gjatë këtij dhjetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Gjermania (0,8 %), Serbia (34,9 %) dhe Rusia (17,7 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-11,7 %), Turqia (-4,6 %) dhe Greqia (-5,7 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Tetor 2020 (%)



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 65,0 %, të gjithë tregtisë. Në Tetor 2020, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 74,7 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 60,6 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (32,8 %), Gjermania (8,4 %), Greqia (7,7 %) dhe Kina (6,6 %).

Shkëmbimet tregtare, për dhjetëmujorin e 2020, me vendet e BE-së zënë 63,2 %, të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Tetor 2020, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 75,2 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 57,8 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (31,4 %), Greqia (7,7 %), Gjermania (7,3 %) dhe Turqia (6,8 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Tetor 2020

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2018	01 - 18	24	24,5	45	27,5	-21	52,5
	02 - 18	24	18,8	46	4,4	-22	52,0
	03 - 18	27	14,6	55	2,5	-28	49,0
	04 - 18	27	11,3	53	5,2	-26	50,9
	05 - 18	30	24,3	57	2,1	-27	53,1
	06 - 18	27	18,1	54	-4,6	-28	49,2
	07 - 18	27	8,2	58	6,0	-31	46,0
	08 - 18	20	10,8	48	-2,3	-28	42,4
	09 - 18	26	8,9	51	-4,4	-25	51,4
	10 - 18	30	21,3	58	1,2	-28	51,7
	Janar – Tetor 18	262	16,0	525	2,8	-264	49,8
2019	01 - 19	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
	02 - 19	23	-5,3	50	8,5	-27	45,4
	03 - 19	28	2,7	56	1,4	-28	49,6
	04 - 19	27	0,1	57	8,9	-30	46,7
	05 - 19	28	-8,0	59	4,0	-31	47,0
	06 - 19	26	-4,1	53	-1,4	-28	47,9
	07 - 19	28	3,7	60	2,7	-32	46,4
	08 - 19	20	-1,8	52	7,1	-32	38,8
	09 - 19	25	-4,9	52	2,3	-27	47,8
	10 - 19	27	-10,2	59	1,8	-32	45,6
	Janar – Tetor 19	252	-3,6	541	2,9	-288	46,6
2020	01 - 20	23	5,3	42	-0,4	-19	54,9
	02 - 20	25	10,6	52	3,9	-27	48,3
	03 - 20	18	-36,0	44	-20,8	-27	40,1
	04 - 20	15	-44,2	36	-36,4	-21	41,0
	05 - 20	22	-22,5	45	-24,2	-23	48,1
	06 - 20	23	-9,6	52	-2,4	-29	44,3
	07 - 20	25	-11,5	57	-5,0	-32	43,3
	08 - 20	19	-3,4	48	-6,7	-29	40,2
	09 - 20	25	1,3	52	0,5	-27	48,2
	10 - 20	27	-0,9	59	(0,01)	-33	45,2
	Janar – Tetor 20	221	-12,2	488	-9,7	-267	45,4

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Tetor 2020

	Eksporte				Importe			
	Tetor 2019	Tetor 2020	Jan. - Tet. 2019	Jan. - Tet. 2020	Tetor 2019	Tetor 2020	Jan. - Tet. 2019	Jan. - Tet. 2020
Vendet e BE-së	21.024	20.003	191.998	166.526	32.436	35.924	311.339	282.116
Austri	199	185	1.549	1.298	503	732	5.756	4.776
Gjermani	1.199	1.954	11.987	13.699	4.280	5.307	37.507	37.819
Greqi	1.096	1.341	10.646	10.642	4.533	5.329	46.675	44.019
Itali	12.530	12.461	121.887	101.711	14.484	15.789	137.146	121.150
Spanjë	3.079	1.155	18.063	13.716	1.037	1.123	9.396	8.052
Kroaci	135	194	923	1.369	543	498	5.747	5.283
Të tjera të BE-së	2.786	2.713	26.943	24.090	7.055	7.146	69.112	61.018
Mbretëri e Bashkuar	76	129	613	663	446	489	4.673	4.176
Kinë	528	469	5.341	3.859	5.037	5.216	49.376	43.077
Kosovë	2.692	2.955	25.320	20.891	723	819	6.624	6.701
Maqedonia e Veriut	785	906	7.062	7.102	755	818	7.119	7.347
Rusi	-	-	75	13	1.259	750	9.912	11.663
SHBA	221	320	3.191	2.609	2.511	929	10.491	7.496
Turqi	137	240	1.746	2.145	6.263	5.248	48.605	46.390
Ukrainë	8	18	128	343	150	214	2.564	3.442
Zvicër	147	50	780	600	1.786	1.159	12.881	8.691
Të tjera	1.410	1.689	15.891	16.641	7.943	7.739	77.033	66.958
Gjithsej	27.027	26.779	252.145	221.391	59.308	59.305	540.618	488.057

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Tetor 2020

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Tetor 2019	Tetor 2020	Jan. - Tet. 2019	Jan. - Tet. 2020	Tetor 2019	Tetor 2020	Jan. - Tet. 2019	Jan. - Tet. 2020
Gjithsej	27.027	26.779	252.145	221.391	59.308	59.305	540.618	488.057
Ushqime. pije. duhan	3.656	4.382	29.076	31.918	9.356	9.630	91.760	91.616
Minerale. lëndë djegëse. en.el.	4.820	3.458	41.415	31.828	6.790	4.842	65.168	43.505
Produkte kimike dhe plastike	654	712	6.544	6.201	8.402	8.531	73.822	73.573
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	218	120	2.053	1.544	1.599	1.338	14.604	10.522
Prodhime druri dhe letre	916	841	7.958	6.954	2.235	2.194	21.445	19.543
Tekstile dhe këpucë	10.346	9.783	100.654	84.990	7.970	8.334	72.396	60.589
Materiale ndërtimi dhe metale	3.964	4.514	38.808	32.978	6.580	6.941	67.374	64.174
Makineri. pajisje dhe pj. këmb.	1.568	2.079	18.084	17.908	13.671	15.104	113.616	105.661
Të tjera	888	889	7.553	7.069	2.706	2.391	20.432	18.875

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milione lekë), Tetor 2020

	Itali		Kosovë		Spanjë		Gjermani	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
Gjithsej	121.887	101.711	25.320	20.891	18.063	13.716	11.987	13.699
Ushqim. pije duhan	7.153	7.737	2.977	3.166	1.079	1.084	1.406	1.527
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	4.696	1.013	6.033	3.822	14.705	11.544	811	1.126
Produkte kimike dhe plastike	1.732	1.666	1.792	1.810	49	102	54	46
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.713	1.343	5	5	188	71	12	27
Prodhime druri dhe letre	5.301	4.227	739	641	4	3	152	311
Tekstile dhe këpucë	78.332	63.900	95	106	1.855	746	6.324	7.503
Materiale ndërtimi dhe metale	11.429	10.302	11.590	9.440	170	118	1.291	944
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	8.381	8.582	621	609	8	26	1.258	1.604
Të tjera	3.150	2.941	1.468	1.291	5	22	678	611

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milione lekë), Tetor 2020

	Itali		Turqi		Greqi		Kina	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
Gjithsej	137.145	121.150	48.605	46.390	46.675	44.019	49.376	43.077
Ushqim. pije duhan	16.166	16.261	4.589	4.396	13.189	13.374	671	636
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	7.196	5.164	3.208	3.070	10.652	7.760	7	7
Produkte kimike dhe plastike	15.333	15.628	6.764	6.991	6.419	6.447	4.731	4.525
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	11.597	8.467	227	259	23	28	642	467
Prodhime druri dhe letre	5.702	4.763	2.884	2.437	2.944	3.027	882	683
Tekstile dhe këpucë	34.113	26.609	14.714	12.890	3.047	3.104	9.639	8.193
Materiale ndërtimi dhe metale	15.726	14.302	8.944	8.066	6.897	6.695	7.819	5.203
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	26.770	25.910	5.545	6.325	2.254	2.381	20.342	19.083
Të tjera	4.542	4.045	1.730	1.956	1.250	1.202	4.644	4.282

Metodologjia

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumania, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri